



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**

Përdorimi i mediave onllajn për monitorimin e premtimeve zgjedhore

Nëntor 2024

Autor: Rasto Kuzhel



International Foundation
for Electoral Systems

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje	3
2. Media onllajn si mjet i llogaridhënies zgjedhore	3
3. Fuqizimi i grupeve të interesit përmes mediave onllajn	4
4. Raste studimore: Përdorimi i medias onllajn si mjet llogaridhënieje gjatë zgjedhjeve .	5
<i>Serbi: Istinomer-i nga CTRTA</i>	6
<i>Sllovaki: Ballafaqimi i votave nga MEMO 98</i>	6
<i>SHBA: Politifakt-i nga Institutit i Poynter-it</i>	7
5. Korniza strategjike për zbatim efektiv.....	8
6. Rekomandimet	10
Bibliografia / Referencat	12

1. Hyrje

Mediat onllajn luajnë rol të dyfishtë në formësimin e llogaridhënies politike, duke vepruar edhe si vektorë të mundshëm të dëmit zgjedhor edhe si forca të fuqishme demokratizuese. Edhe pse mund ta përforcojnë përmbajtjen emocionale dhe të rreme, duke e rrënuar besimin e procesit zgjedhor, këto platforma kanë gjithashtu potencialin e fuqizimit të votuesve, mobilizimin zgjedhësve dhe rritjen e llogaridhënies.

Premtimet zgjedhore, thelbësore për formësimin e pritjeve të votuesve dhe legjitimitetit të politikanëve, shpesh përballen me mekanizma të dobët tradicionalë të llogaridhënies pas zgjedhjeve. Mediat onllajn e transformojnë këtë pejzash duke mundësuar përcjelljen në kohë reale të premtimeve dhe fazave të tyre të përmbajtjes së tyre, duke zgjeruar qasjen në informacionin kritik dhe nxitjen e dialogut mes qytetarëve, organizatave qytetare (OQ-ve), si dhe mediave. Duke siguruar hapësirë dinamike të angazhimit dhe nxitjes së transparencës, këto platforma mund të forcojnë qeverisjen demokratike.

Ky punim hulumton përdorimin e platformave të mediave onllajn për monitorimin e premtimeve zgjedhore. Ka për synim që të nënvizojë shembujt e suksesshëm, praktikat më të mira dhe mësimin e nxënë nga përvojat e mëparshme në vendet e ndryshme, duke ofruar një kornizë që mund të zbatohet në zgjedhjet e ardhshme në Maqedoninë e Veriut.

2. Media onllajn si mjet i llogaridhënies zgjedhore

Media onllajn është term i gjerë dhe përfshin forma të ndryshme të përmbajtjes digjitale së shpërndarë në internet. Shembujt kryesorë të platformave dhe formateve i përfshijnë: portalet e pavarura informative, mediat sociale (Fejsbuk, Instagram, Twitter, etj.), përmbajtjen video dhe të emetuar në kohë reale, siç janë Jutjub, Netfliks, etj.

Media onllajn ndikon në mënyrë domethënëse në llogaridhënien politike, me potencialin për të forcuar përmbajtjen emocionale dhe të rreme që rrënon besimin e procesit zgjedhor, por edhe duke fuqizuar votuesit, duke mobilizuar zgjedhësit dhe duke rritur llogaridhënien. Duke mundësuar monitorimin në kohë reale dhe duke nxitur angazhimin e drejtpërdrejtë me zotimet politike, media onllajn shërben si një mjet i fuqishëm i promovimit të transparencës dhe forcimit të qeverisjes demokratike.

Premtimet zgjedhore janë pjesë e rëndësishme e fushatave zgjedhore, duke formësuar pritjet e votuesve dhe duke shërbyer si matës të legjitimitetit të politikanëve. Megjithatë, pas zgjedhjeve, mekanizmat tradicionalë të llogaridhënies¹ shpeshherë luftojnë që të mbajnë momentin e nevojshëm për përcjelljen dhe sigurimin e përmbajtjes së këtyre përkushtimeve. Mediat onllajn e transformojnë këtë dinamikë duke siguruar komunikimin në kohë reale, duke mundësuar ndërveprimin e drejtpërdrejtë të funksionarëve të zgjedhur me qytetarët dhe duke nxitur transparencën.

Mediat onllajn mund ta transformojnë llogaridhënien e pushtetit duke mundësuar përcjelljen në kohë reale të premtimeve zgjedhore dhe fazave të tyre të përmbajtjes sy tyre. Këto mjete zgjerojnë qasjen e informacionit kritik, duke siguruar që përkushtimet e politikanëve kanë përhapje të gjerë dhe qasje të lehtë publike. Ato gjithashtu sigurojnë hapësirë dinamike për

¹ Disa forma të mekanizmave tradicionalë të llogaridhënies janë: seancat parlamentare, seancat e komitetit, diskutimet e buxhetit, paditë kundër korrupsionit, shqyrtimet e revizionit për praktikat financiare dhe operative etj.

dialog, ku OQ-të, mediat dhe qytetarët mund të angazhohen në mënyrë të drejtpërdrejtë me përfaqësuesit e zgjedhur, duke nxitur transparencën dhe duke fuqizuar grupet e interesit për të vlerësuar progresin.

3. Fuqizimi i grupeve të interesit përmes mediave onllajn

Efektiviteti i mediave onllajn shtrihet në aftësinë për t'i pajisur grupet kryesore të interesit me mjetet e monitorimit të premtimeve zgjedhore. Ky punim përqendrohet në grupet vijuese: opinioni i përgjithshëm publik, organizatat qytetare (OQ-të) dhe gazetarët dhe partitë politike në opozitë.

Opinion i përgjithshëm publik

Opinion i përgjithshëm është në qendër të çdo mekanizmi demokratik të llogaridhënies, ndërsa mediat onllajn i fuqizojnë qytetarët për të luajtur rol aktiv në monitorimin e premtimeve zgjedhore. Duke i ofruar platformat e të shprehurit, mediat onllajn u mundësojnë individëve që t'i shpalosin shqetësimet, t'i shkëmbejnë përvojat e tyre dhe të kontribuojnë në mënyrë aktive në përpjekjet për llogaridhënie. Vallë përmes bllogjeve, forumeve ose seksioneve për komente, qytetarët mund të angazhohen në diskutime kuptimplota rreth përkushtimeve zgjedhore, duke e zgjeruar ndikimin e tyre kolektiv. Ky demokratizim i komunikimit siguron se zërat e përkatësive të ndryshme janë duke u dëgjuar, duke nxitur gjithëpërfshirjen në procesin e llogaridhënies.

Mediat onllajn gjithashtu nxisin bashkëpunimin dhe aktivizmin qytetar mes qytetarëve. Platformat si grupet në Facebook, kanalet e WhatsApp-it dhe forumet e dedikuara mundësojnë mbledhjen e informacionit nga kontributet e individëve, duke u mundësuar bashkësive që të përcjellin në mënyrë kolektive dhe të vlerësojnë përmbajtjen e premtimeve zgjedhore. Aktivizmi digjital, i përforcuar nga lëvizjet siç janë #MeToo (Edhe unë gjithashtu) ose #BlackLivesMatter (Jeta e zezakëve ka rëndësi), tregon fuqinë e iniciativave të cilat i ndërmarrin qytetarët për të ushtruar presion ndaj politikanëve me qëllim që t'u përmbahen zotimeve të tyre. Duke përdorur këto mjete, opinioni mund t'i transformojë shqetësimet individuale në veprim kolektiv, duke forcuar kornizën e llogaridhënies së përgjithshme në qeverisjen demokratike.

Organizatat qytetare

OQ-të luajnë rol thelbësor në mbushjen e zbrazëtirës ndërmjet qytetarëve dhe pushtetit, ndërsa mediat onllajn rritin aftësinë e tyre për t'i monitoruar premtimet zgjedhore. Duke përdorur platformat onllajn, OQ-të mund të forcojnë vetëdijen rreth premtimeve të papërmbajtura dhe llogaridhënies politike. Fushatat që përdorin hashtagje, infografikë dhe video përmbajtje mund t'i sjellin në vëmendje çështjet e rëndësishme, duke nxitur ligjërimin publik dhe duke ushtruar presion ndaj konkurrentëve politikë që t'u dalin zot premtimeve të tyre. Shtrirja e gjerë e mediave onllajn siguron që bisedat rreth premtimeve zgjedhore janë gjithëpërfshirëse dhe të qasshme për audiencat e ndryshme.

Mediat onllajn lehtësojnë po ashtu bashkëpunimin mes OQ-ve, duke u mundësuar atyre që të lidhin partneritet me organizata të tjera, me media dhe grupe qytetarësh për të nxitur veprimin e përbashkët. Duke shkëmbyer burime, të dhëna dhe strategji, OQ-të mund të bashkërendojnë përpjekjet për të monitoruar dhe raportuar mbi premtimet politike në mënyrë më efektive. Si plotësim, mjetet analitike onllajn i fuqizojnë OQ-të për përcjelljen e prurjeve politike dhe qëndrimin e opinionit, duke ofruar të dhëna të vlefshme mbi perceptimin e opinionit publik për përkushtimet zgjedhore. Kjo qasje e vënë në veprim nga të dhënat u mundëson organizatave qytetare që t'i identifikojnë boshllëqet në llogaridhënie dhe të përfaqësojnë për intervenime të synuara, duke forcuar rolin e tyre si mbikëqyrës të qeverisjes demokratike.

Gazetarët

Gazetarët luajnë rol kryesor në hulumtimin dhe informimin mbi zhvillimet politike, ndërsa mediat onllajn rritin në mënyrë domethënëse kapacitetin e tyre për të monitoruar premtimet zgjedhore të bëra nga konkurruesit. Mediat onllajn shërbejnë si mjete të fuqishme për mbledhjen e të dhënave, duke ofruar përditësime në kohë reale mbi aktivitet e politikanëve, ngjarjet e fushatave dhe deklaratat e politikave. Ato gjithashtu u mundësojnë gazetarëve që t'i përcjellin përkushtimet e dhëna zgjedhore, duke e arkivuar këtë informacion për analizën e ardhshme. Këto platforma gjithashtu sigurojnë qasje në pjesën dërrmuese të përmbajtjes së krijuar nga përdoruesi, duke ofruar të dhëna unike mbi pikëpamjet e opinionit dhe reagimet mbi zotimet politike. Me anë të përdorimit të këtyre mjeteve, gazetarët mund të bëjnë regjistrime të detajuara të premtimeve të fushatës dhe të analizojnë modelet brenda retorikës politike me kalimin e kohës.

Mediat onllajn gjithashtu forcojnë aftësinë e gazetarëve në verifikimin e pretendimeve të bëra nga konkurruesit politikë. Platformat sigurojnë qasje të menjëhershme në të dhënat, deklaratat zyrtare dhe përmbajtjen e arkivuar, duke mundësuar kryqëzimin e referencave dhe verifikimin e informacionit. Veçoritë ndërvepruese në mediat onllajn mundësojnë gazetarët për të angazhuar audiencat në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke nxitur përpjekjet për verifikimin e fakteve. Mjetet, siç janë sondazhet, sesionet e pyetjeve dhe përgjigjeve dhe emetimet e drejtpërdrejta krijojnë mundësi për dialog kuptimplotë me opinionin, duke inkurajuar shqyrtimin kolektiv të premtimeve zgjedhore. Kjo qasje ndërvepruese jo vetëm që rrit transparencën, por mund të ndihmojnë edhe në ndërtimin e besimit të opinionit në gazetari, duke e pozicionuar median si një forcë vitale e cila kërkon llogaridhënie nga konkurrentët politikë për zotimet e tyre.

Partitë politike në opozitë

4. Raste studimore: Përdorimi i medias onllajn si mjet llogaridhënieje gjatë zgjedhjeve

Në këtë seksion bëhet shqyrtimi se si media online është përdorur në mënyrë efektive si një mjet për llogaridhënien zgjedhore përmes rasteve studimore nga Serbia, Sllovakia dhe Shtetet e Bashkuara. Këta shembuj nënvizojnë qasjet novatore, siç janë platformat për verifikimin e fakteve, aplikacionet këshilluese të votimit dhe përcjellësit e premtimeve, duke treguar ndikimin e tyre në monitorimin e përkushtimeve zgjedhore, nxitjen e transparencës dhe nxitjen e angazhimit të informuar qytetar.

Serbi: Istinomer-i nga CRTA²

Projekti Istinomer (Vërtetëmatësi) i CRTA-s është mjet i fuqishëm verifikimi faktesh dhe monitorimi, me të cilin vlerësohet saktësia, konsistenca dhe përmbajtja dhe është i dobishëm si për votuesit, ashtu edhe për politikëbërësit. Duke përdorur metodologji transparente të bazuar në të dhëna të verifikueshme, Istinomer-i përcjell deklaratat dhe përkushtimet e bëra të politikanëve, duke i kategorizuar në vlerësime, të tipit “i përmbajtur,” “i papërmbajtur,” ose “ende s’ka filluar.” Kjo i mundëson votuesit që të vlerësojnë vallë partitë politike përputhen me vlerat dhe pozicionet e tyre për çështjet kritike.

Gjatë zgjedhjeve, Istinomer-i paraqitet si një burim i paçmuar për votuesit, i cili ofron të dhëna për punën e mëparshme të partive politike dhe të kandidatëve dhe ndihmon në dallimin ndërmjet premtimeve reale dhe retorikës së zbrazët. “Matësi i së vërtetës” dhe baza e të dhënave e vlerësimeve të tij mund të përdoren nga votuesit për krahasimin e platformave partiake me rezultatet e deritashme të kandidatëve, duke nxitur vendimmarrje të informuar.

Në periudhat jashtë zgjedhore, Istinomer-i vazhdon të kërkojë përgjegjësi nga zyrtarët publikë duke monitoruar progresin e premtimeve të dhëna gjatë fushatave. Ky shqyrtim i vazhdueshëm siguron se politikanët mbajnë përgjegjësi për përkushtimet e tyre gjatë gjithë mandatit. Si plotësim Istinomer-i e edukon opinionin për implikimet më të gjëra të deklaratave politike dhe të manipulimeve, duke nxitur zgjedhës më të informuar dhe më të angazhuar.

Me arkivimin dhe përditësimin e rregullt të gjetjeve të tij, Istinomer-i jo vetëm që e forcon llogaridhënien demokratike, por edhe e kundërshton “kulturën e harresës,” ku premtimet e papërmbajtura janë anashkaluar me kalimin e kohës. Ky funksionalitet me qëllim të dyfishtë—udhëzim në kohën e zgjedhjeve dhe llogaridhënie të vazhdueshme—e bën Istinomer -in mjet efektiv për monitorimin dhe përfundimin e besimit në proceset demokratike.

Slllovakia: Ballafaqimi i votave nga MEMO 98³

Iniciativa ballafaqimi i votave për Zgjedhjet parlamentare në Sllovakia, në vitin 2023 dhe për Zgjedhjet presidenciale dhe Parlamentin Evropian në vitin 2024 tregoi për potencialin e Aplikacioneve këshilluese të votimit në fuqizimin e votuesve me njohuri dhe lehtësimin e pjesëmarrjes së informuar në zgjedhje. Duke përputhur parapëlqimet politike të përdoruesve me partitë politike ose kandidatët, këto mjete u mundësuan votuesve për t’i harmonizuar zgjedhjet e tyre me partitë që ndanin vlerat e tyre, duke e zhvendosur fokusin nga personalitetet te politikat. Projekti zgjedhjet parlamentare sllovaqe në vitin 2023 tërhoqi më se 219,000 regjistrime mjeteve dhe 107,550 plotësime kuizesh, duke përfshirë votuesit të cilët votojnë për herën e parë dhe të dytë dhe rriti daljen e të rinjve për 4% në raport me vitin 2020 (dhe për 16 % në kategorinë e atyre që votojnë për herën e parë dhe të dytë në krahasim me synimet e tyre të shprehura në sondazhin për matjen opinionit publik të zbatuar disa muaj përpara zgjedhjeve). Në mënyrë të ngjashme, mjetet e ballafaqimit të votave për Zgjedhjet presidenciale dhe për zgjedhjet e Parlamentit Evropian kapën mbi 358,000 gjegjësisht 108,000 vizitorë unikë, duke shfaqur tërheqjen dhe ndikimin e tyre të gjerë.

Aplikacionet këshilluese të votimit luajnë rol transformues përtej zgjedhjeve, duke ofruar mekanizëm për llogaridhënie të vazhdueshme politike. Gjatë periudhave jashtë zgjedhore, këto

² CRTA. (n.d.). *Istinomer*. Marrë nga <https://www.istinomer.rs/>

³ MEMO 98 dhe KohoVolit.eu. (pa datë). *Volebná kalkulačka*. InfoVolby.sk. Marrë nga <https://infovolby.sk/tema/volebna-kalkulacka>

mjete mund të përshtaten për të monitoruar sesa partitë dhe përfaqësuesit e zgjedhur i përmbahen premtimeve të tyre parazgjedhore. Duke i ndërthurur politikat e mbështetura nga votuesit gjatë zgjedhjeve me ligjet e miratuara në parlament, aplikacionet këshilluese të votimit mund të ofrojnë njohuri mbi konsistencën ndërmjet zotimeve zgjedhore dhe veprimtarive legjislative. Kjo qasje nxit transparencën, i mban votuesit të informuar dhe forcon llogaridhënien demokratike. Më tej, angazhimi i vazhdueshëm përmes këtyre aplikacioneve gjatë cikleve legjislative ndërton një qytetari më të përgjegjshme politike dhe përforcon besimin në proceset demokratike.

Përtej monitorimit të premtimeve zgjedhore, aplikacionet këshilluese të votimit mund të shërbejnë edhe si mjete edukative për thellimin e njohurive të qytetarëve për proceset politike dhe ndikimin e vendimeve legjislative. Duke integruar përditësimet në kohë reale mbi aktivitetet parlamentare, siç janë regjistrimet e votimeve, projekt-ligjet e propozuara dhe rezultatet e politikave, aplikacionet këshilluese të votimit mund t'u ofrojnë përdoruesve pasqyrë të qartë se si përfaqësuesit veprojnë ndaj çështjeve kritike. Kjo transparencë mundëson plotësimin e zbrazëtirës ndërmjet qytetarëve dhe ligjbërësve, veçanërisht për të rinjtë ose ata që votojnë për herën e parë të cilët mund të ndihen të shkëputur nga sistemet politike tradicionale. Si plotësim, duke ofruar alarme të përshtatura dhe përditësime bazuar mbi parapëlqimet e politikave të përdoruesve, aplikacionet këshilluese të votimit mund të përmbajnë angazhimin dhe të nxisin pjesëmarrjen aktive në ligjërimin publik, duke kultivuar kulturën e llogaridhënies dhe angazhimin e informuar qytetar gjatë mbarë ciklit zgjedhor.

SHBA: Politifakt-i nga Institutit i Poynter-it⁴

PolitiFakt-i luan rol kryesor në ndihmën e votuesve për të vlerësuar përgjegjësinë politike duke ofruar mjete dhe metodologji për të monitoruar premtimet zgjedhore. Matësit e tij të premtimeve, siç janë përcjellësi i premtimeve të Bajdenit ose Tramp-O-Matësi, janë pjesë qendrore e këtij misioni. Këto mjete vlerësojnë përkushtimet e fushatës në bazë të rezultateve të verifikuara në vend të synimeve, duke i mundësuar votuesit të shohin progresin dhe dështimin e premtimeve kohë pas kohe. Çdo premtim është kategorizuar në statuse, si “Në punë e sipër,” “I ngecur,” “Kompromis,” “Premtim i mbajtur,” ose “Premtim i pambajtur”, duke ofruar pasqyrë të qartë të rezultatit politik. Duke përcjellë premtimet përmes verifikimit rigoroz të fakteve, PolitiFakt-i fuqizon votuesit me informacion të qasshëm, jopartiak rreth asaj se vallë politikanët i përmbahen zotimeve të tyre.

Ky mjet ka vlerë të veçantë jashtë periudhave zgjedhore, duke nxitur llogaridhënien e vazhdueshme politike. Gjatë qeverisjes, votuesit mund ta përdorin PolitiFakt-in për të vlerësuar si veprimet e politikanëve harmonizohen me retorikën e fushatës dhe prioritetet e tyre. Si për shembull, nëse një kandidat ka premtuar reforma madhore në shëndetësi, ndërsa progresi ka ngecur, atëherë votuesit mund të kërkojnë llogari prej tyre ose të rregullojnë mbështetjen e tyre bazuar në të dhënat e rezultateve.

Si plotësim, PolitiFakt-i ofron transparencë sa partitë politike ose individët harmonizohen me pozicionet e votuesve. Duke treguar se cilat premtime janë mbajtur ose nuk janë mbajtur, u ndihmon qytetarëve që të vlerësojnë se vallë zyrtarët e tyre të zgjedhur i përfaqësojnë mirëfilli interesat e tyre. Këto të dhëna u mundësojnë votuesve që të bëjnë zgjedhje të informuara në

⁴ Institutit i Poynter-it për studime mediatike. (pa datë). *PolitiFact*. Marrë nga <https://www.politifact.com/>

zgjedhjet e ardhshme dhe të përfaqësojnë për një përfaqësim më të fuqishëm në kohë reale, duke e bërë PolitiFakt-in mjet të domosdoshëm për monitorimin e demokracisë në veprim.

Përtej përcjelljes të premtimeve, puna e PolitiFakt-it është mjet i fuqishëm për nxitjen e angazhimit qytetar dhe luftimit të dezinformacionit. Vlerësimet e Vërtetëmatësit të tij ofrojnë një mënyrë të qartë, të qasshme për vlerësimin e saktësisë së deklaratave politike, duke bërë që votuesit t'i kuptojnë më thellësisht çështjet konkrete. Kjo u ndihmon individëve që të njohin se vallë përfaqësuesit e tyre po u përmbahen zotimeve të tyre ose po zhyten në retorikë çorientuese. Duke u përqendruar në transparencë dhe duke u mbështetur në burimet parësore dhe analizat e ekspertëve, PolitiFakt-i ndihmon në ndërtimin e besimit në proceset politike. Përveç kësaj, qëndrimi i tij jopartiak siguron se mjetet dhe gjetjet e tij janë të besueshme për votuesit e mbarë spektrit politik, duke nxitur dialogun e informuar dhe llogaridhënien në qeverisje.

5. Korniza strategjike për zbatim efektiv

Mësimi i nxënë nga shembujt e Serbisë, Sllovakisë dhe SHBA-ve nënvizon rëndësinë e novacionit, qasshmërisë dhe angazhimit të vazhdueshëm në përdorimin e mediave onllajn për përgjegjësinë zgjedhore. Këtu janë disa nga gjërat e rëndësishme për t'u marrë parasysh gjatë përdorimit të mediave onllajn për monitorimin e premtimeve zgjedhore:

Transparenca dhe verifikueshmëria: Mjetet si Istinomer (Serbi) dhe PolitiFact (SHBA) tregojnë se mekanizmat llogaridhënës duhet të mbështeten në teknologjitë transparente dhe të dhënat e verifikueshme. Kategorizimi i premtimeve me matjet e pastra, siç janë “I mbajtur” ose “I pambajtur,” siguron besimin dhe mundëson votuesit të vlerësojnë me efektivitet rezultatin politik.

Fuqizimi i votuesit përmes personalizimit: Ballafaqimi i votave i Sllovakisë nënvizon fuqinë e personalizimit të angazhimit të votuesve. Duke përputhur parapëlqimet e votuesve me politikat partiake, mjetet e këtilla jo vetëm që lehtësojnë vendimmarrjen e informuar gjatë zgjedhjeve, por edhe mbështesin llogaridhënien politike duke ndjekur veprimtaritë e legjislacionit kundrejt premtimeve të fushatës.

Angazhimi i vazhdueshëm përtej zgjedhjeve: Fuqia e përbashkët te këta shembuj është përkushtimi i tyre për nxitjen e llogaridhënies në mbarë ciklin zgjedhor. Monitorimi njëvjeçar i Istinomer-it, matja e premtimeve e PolitiFakt-it dhe funksionaliteti paszgjedhor i Ballafaqimit të votave ilustrojnë vlerën e mirëmbajtjes së vetëdijes publike dhe vëzhgimin jashtë periudhës zgjedhore.

Edukimi dhe gjithëpërfshirja: Çdo rast thekson rolin e edukimit publik në forcimin e proceseve demokratike. Qoftë nëpërmjet verifikimit të fakteve, mjeteve të përputhjes së votuesve ose ndjekjes së progresit, këto platforma angazhojnë demografi të ndryshme, veçanërisht votuesit e rinj ose votuesit që votojnë për herë të parë, duke nxitur qytetari të vëmendshme politike dhe gjithëpërfshirëse.

Lufta kundër dezinformimit: Qëndrimi proaktiv kundër dezinformimit, siç shihet me Vërtetëmatësin e PolitiFakt-it, tregon nevojën e integritetit të zbulimit dhe korrigjimit të dezinformimit në përpjekjet për llogaridhënie me qëllim që të ndërtohet besimi i publikut dhe të parandalohet manipulimi.

Për të maksimizuar potencialin e mediave onllajn për llogaridhënien zgjedhore, është gjithashtu thelbësore të vendoset metrika e qartë dhe e matshme për përcjelljen e premtimeve, siç janë afatet, shpërndarja e buxhetit dhe momentet historike të zbatimit të politikave. Transparenca përmirësohet më tej duke nxitur angazhimin publik përmes mjeteve ndërvepruese si sondazhet, seancat e drejtpërdrejta të pyetjeve dhe të përgjigjeve dhe platformat për përmbajtjen e krijuar nga përdoruesi. Fushatat e drejtuara përmes hashtagjeve, siç janë #KërkoniLlogariPrejTyre, shërbejnë si mjete të fuqishme të tërheqjes së vëmendjes dhe të mbështetjes së bisedave rreth përkushtimeve politike, duke siguruar se zyrtarët politikë vëzhgohen gjatë tërë kohës. Si plotësim, përdorimi i analizës së avancuar të të dhënave, duke përfshirë analizën e qëndrimeve dhe përcjelljen e prurjeve, mundësojnë që palët e interesit të përcjellin opinionin publik, të vlerësojnë rezultatin politik dhe të identifikojnë zbrazëtirat në qeverisje në kohë reale.

Bashkëpunimi dhe edukimi kanë po të njëjtën rëndësi. Ndërtimi i partneriteteve me mediat, OQ-të, influenserët dhe organizatat teknologjike rritin shtrirjen dhe ndikimin e fushatave monitoruese, me mediat që ofrojnë shikueshmërinë dhe OQ-të që sigurojnë saktësinë e të dhënave. Duke promovuar arsimimin digjital përmes seminareve dhe fushatave për ngritjen e vetëdijes qytetarët pajisen me shkathtësitë për të verifikuar përmbajtjen e plasuar, për të luftuar dezinformimin dhe për t'u angazhuar në hapësirat onllajn në mënyrë konstruktive.

Implikimet për Maqedoninë e Veriut

Në Maqedoninë e Veriut monitorimi i premtimeve zgjedhore mund të përmirësohet në mënyrë domethënëse me anë të integritetit të mjeteve plotësuese mediatike digjitale dhe onllajn për të nxitur transparencën, llogaridhënien dhe angazhimin publik. Depërtimi i madh në internet i vendit dhe përdorimi aktiv i platformave të mediave sociale ofron mundësinë e përcjelljes së premtimeve zgjedhore në mënyrë sistematike. Zhvillimi i metrikëve të qartë për monitorimin e përkushtimeve, siç është vendosja e afateve, përcjellja e momenteve historike në zbatimin e politikave dhe monitorimi i shpërndarjeve të buxhetit, do t'i mundësonte mediat, OQ-të dhe qytetarët që të vlerësojnë rezultatin e politikanëve në raport me përkushtimet e tyre zgjedhore. Duke pasur parasysh mungesën momentale të rregullimit për aktivitetet e fushatës për platformat onllajn, iniciativat e monitorimit të udhëhequra nga OQ-të mund të luajnë rol të rëndësishëm në forcimin e integritetit zgjedhor dhe transparencës.

Angazhimit publik duhet t'i jepet përparësi me anë të përdorimit të mjeteve onllajn me të cilat qytetarët ndërveprojnë me politikanët, e paraqesin dhunën dhe e përcjellin progresin e përkushtimeve. Nxitja e arsimimit digjital dhe e fushatave për ngritjen e vetëdijes do t'i fuqizojë votuesit për ta verifikuar informacionin, për ta njohur dezinformacionin dhe për të kërkuar llogari prej aktorëve politikë për premtimet e tyre. Këto masa, të kombinuara me monitorimin onllajn të premtimeve zgjedhore, mund të ndihmojnë në forcimin e transparencës dhe llogaridhënies në proceset zgjedhore të Maqedonisë së Veriut.

Konkluzion

Integrimi i mediave onllajn në proceset demokratike paraqet mundësi transformuese për nxitjen e llogaridhënies, transparencës dhe angazhimit qytetar. Duke i pajisur grupet kryesore të interesit—gazetarët, OQ-të dhe opinionin—me mjetet e fuqishme për monitorimin e premtimeve zgjedhore, mediat onllajn mund ta plotësojnë zbrazëtirën ndërmjet përkushtimeve politike dhe rezultateve të prekshme të qeverisjes. Rastet studimore nga Serbia, Sllovakia dhe Shtetet e Bashkuara tregojnë se transparenca, angazhimi i vazhdueshëm, mjetet e personalizuara të votuesve dhe përpjekjet proaktive janë elemente thelbësore të kornizave efektive të llogaridhënies. Këto mësimë nënvizojnë rëndësinë e matjeve të qarta, strategjive të mbështetura nga të dhënat dhe qasjeve bashkëpunuese, duke siguruar se premtimet zgjedhore japin rezultate të zbatueshme, si dhe theksojnë nevojën e vëzhgimit gjatë mbarë ciklit zgjedhor.

Për Maqedoninë e Veriut, shfrytëzimi i këtyre të dhënave ofron rrugë për trajtimin e zbrazëtirave ekzistuese në kuadër të llogaridhënies politike dhe transparencës. Përmes miratimit të mjeteve digjitale për përcjelljen e përkushtimeve, forcimin e mbikëqyrjes institucionale dhe nxitjen e arsimimit digjital të qytetarëve, vendi mund të përmirësojë proceset demokratike dhe besimin e publikut.

6. Rekomandimet

Për të zbatuar me efikasitet monitorimin e mediave onllajn të premtimeve zgjedhore, rekomandohen disa strategji:

Zhvillimi i mjeteve të qasshme të monitorimit

Të krijohen platforma të thjeshta dhe të përshtatshme për përdorim onllajn ose aplikacione celulari që do t'u mundësojnë qytetarëve të përcjellin progresin e premtimeve zgjedhore. Këto mjete mund të përfshijnë shfaqjen vizuale të premtimeve në një vend, siç janë kategoritë: “Në progres,” “I mbajtur,” ose “I pambajtur.” Përdorimi i platformave ekzistuese me shpenzime të vogla, siç janë ueb faqet ose faqet e mediave sociale, siguron qasjen e audiencës më të re me burime të kufizuara.

Shfrytëzimi i mediave onllajn për angazhim publik

Të shfrytëzohen platformat popullore si Facebook-u dhe Instagram-i, të cilat kanë depërtim të konsiderueshëm në Maqedoninë e Veriut, me qëllim që të zhvillohen fushata për ngritjen e vetëdijes dhe angazhimit të mbarë opinionit në përpjekjet e monitorimit. Veçoritë interaktive, siç janë sondazhet, kuizet, dhe sesionet e pyetjeve dhe përgjigjeve mund ta inkurajojnë rininë për të marrë pjesë në diskutimet për llogaridhënien politike duke mos kërkuar ndonjë investim të konsiderueshëm financiar.

Promovimi i arsimimit digjital

Të zhvillohen punëtoritë onllajn ose uebinarët e përshtatshëm për të rinjtë ku do të mësojnë sesi të verifikojnë informacionin, të njohin dezinformacionin dhe të kontribuojnë në mënyrë aktive në përpjekjet e monitorimit. Të krijohet partneritet me shkollat, universitetet, ose organizatat rinore për t'i futur këto shkathtësi në programet ekzistuese arsimore, duke reduktuar shpenzimet dhe duke siguruar pjesëmarrjen e gjerë.

Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet grupeve të interesit

Të ndërtohen partneritete me OQ-të, me mediat dhe grupet e të rinjve me njohuri teknologjike për të bashkuar burimet dhe ekspertizën. Për shembull, OQ-të mund t'i verifikojnë të dhënat ndërsa vullnetarët e rinj mund t'i përdorin mjetet digjitale për të shpërndarë gjetjet përmes mediave sociale, duke krijuar model bashkëpunimi që maksimizon ndikimin me burime minimale.

Përdorimi i të dhënave ekzistuese dhe i analitikes

Të përdoren mjete analitike të cilat kanë qasje të lehtë në platformat e mediave sociale që të monitorohet qëndrimi i opinionit publik dhe angazhimi me premtimet zgjedhore. Këto mjete mund të përcjellin sesi angazhimet politike jehojnë në opinion, duke ofruar të dhëna të vlefshme lidhur me përfaqësimin e mëtejshëm dhe përpjekjet e shtrirjes pa bërë shpenzime plotësuese.

Inicimi i fushatave 'hashtag'

Të nisët me iniciativat e ashtuquajtura hashtag, siç janë #PremtimetKanëRëndësi ose #PërcillniPremtimet, për të ngritur vetëdijen dhe për të mbajtur diskutime të vazhdueshme lidhur me angazhimet zgjedhore. Inkurajimi i të rinjve për të krijuar dhe shpërndarë përmbajtje duke i përdorur këto hashtagje mund ta bëjë fushatën virale dhe të qëndrueshme me shpenzime minimale.

Të sigurohet angazhimi pas zgjedhjeve

Të bëhet monitorimi gjatë gjithë vitit duke raportuar rregullisht për statusin e premtimeve përmes mediave me shpenzime të ulëta, siç janë infografikët, videot ose postimet në bllogje. Angazhimi i qëndrueshëm siguron se llogaridhënia është e rëndësishme edhe përtej periudhave zgjedhore, me çka forcohet rëndësia e qeverisjes dhe përmbushen përkishtimet. Duke i zbatuar këto strategji me kosto efektive dhe me fokus në rininë, Maqedonia e Veriut mund të bëjë monitorimin efektiv të premtimeve zgjedhore, të fuqizojë popullatën e saj të re dhe të forcojë mekanizmat e saj të llogaridhënies demokratike.

Bibliografia / Referencat

UNESCO. (2021). *Zgjedhjet në kohën digjitale: Një udhëzues për praktikuesit e zgjedhjeve* (R. Krimmer, A. Rabitsch, R. Kužel, M. Achler, & N. Licht, Autorët). UNESCO. Marrë nga <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000382102>

Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR). *Zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare të Maqedonisë së Veriut, 24 prill dhe 8 maj 2024: Raport përfundimtar*. OSBE, 2024. Në dispozicion në <https://www.osce.org/files/f/documents/5/e/576648.pdf>

Komisioni Evropian. *Raporti për Maqedoninë e Veriut 2024*. Dokument pune i stafit të Komisionit, shoqëruar me Komunikatën mbi politikën e zgjerimit të BE-së 2024, SWD (2024) [Numri i Dokumentit], 30 tetor 2024. Në dispozicion në [European Neighbourhood Policy and Enlargement Negotiations](https://ec.europa.eu/european-neighborhood-policy-and-enlargement-negotiations/).

Kužel, R. (pa datë). *Monitorimi i mbulimit mediatik të zgjedhjeve: Pako mjetesh për organizatat e shoqërisë civile*. Këshilli i Evropës, në bashkëpunim me Zyrën e Këshillit të Evropës në Ukrainë. Marrë nga <https://rm.coe.int/monitoring-of-media-coverage-of-elections-toolkit-for-civil-society-or/1680a06bc6>

Martin-Rozumiłowicz, B., & Kužel, R. (gusht, 2019). *Mediat sociale, dezinformacioni dhe integriteti zgjedhor*. IFES Punim. Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES). Marrë nga <https://www.ifes.org/publications/social-media-disinformation-and-electoral-integrity>

Mohim përgjegjësie: Ky prezantim është bërë në kuadër të Programit për mbështetjen e zgjedhjeve të Qeverisë së Zvicrës, i zbatuar nga Fondacioni ndërkombëtar për sistemet zgjedhore (IFES). Qëndrimet, opinionet dhe përmbajtja e përfshirë në këtë prezantim nuk i pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e donatorit, projektit ose organizatës implementuese.